

**STATUT DHE AKT THEMELIMI
PER
SHOQERINE
“PARKIM EKSPO” SH.P.K.
(Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar)**

Ne baze te ligjit 9901, date 14.04.2008 “Per tregetaret dhe shoqerite tregtare”,
dhe, ligjit nr.9723. date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit” une i
nenshkruari shpall si me poshte vijon:

**Neni 1
FORMIMI I SHOQERISE**

Formohet shoqeria e quajtur **“PARKIM EKSPO” SH.P.K.** (qe ketu e me poshte referuar si “Shoqeria”), e cila themelohet nga 1 Ortak me 100 % kontribuite si me poshte :

1- Z. Luan Mata, i biri i Zeqir Mata, shtetas shqiptar, lindur ne 01.05.1960 dhe banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me numer leternjoftimi 032648803 dhe mbajtes i pasaportes me numer personal G00501284L, madhor e me zotesi te plete juridike per te vepruar, ortak me 100% te kontributeve baraz me 100.000 leke.

**Neni 2
QENDRA E SHOQERISE**

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen: Bulevardi Gjergj Fishta, Godine Polifunksionale Ekspozita Building, 3+24 kat me 5 kat parkim dhe sherbime nentoke, Tirane.

Neni 3



KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jetë e pacaktuar.
Shoqeria mund te perfundoje, te vihet ne likujdim perpara ketij afati ose mund te zgjase aktivitetin e saj me vendim te Asamblese se Ortakeve .

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshtë:

-Parkim

- Shoqeria do te ushtroj veprimtari edhe ne fushat e meposhtme:

1. Importimin dhe eksportimin, prodhimin, perpunimin, transformimin dhe tregtimin e mallrave dhe paisjeve te ndryshme te konsumit, paisjeve elektronike, materialeve te ndertimit dhe mallrave ushqimore.
2. Shoqeria mund te bleje, te hyje ne marredhenie *leasing* dhe te marre apo te jape me qira terrene, impiante dhe uzina, mund kryeje, pervec aktiviteve tregtare edhe aktivitete si industriale ashtu edhe bujqesore.
3. Shoqeria mund te kryeje cdo operacion tregtar, operacione qe lidhen me pasurite e luajteshme dhe te paluajteshme, financiare dhe kreditore si edhe te bleje apo shese apo te marre apo jape me qera pasuri, si edhe te kete interesa apo pjesemarrje ne shoqeri, ente, konsorciume, te themeluara apo ne themelim e siper, qe kane nje objekt te ngjashem apo funksional ne arritjen e qellimeve te Shoqerise, si dhe te ofroje garanci, te marre hua dhe te ofroje garanci, pasurore apo personale, ne favor te te treteve. Ne per gjithesi, shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te saj.
4. Pritje, akomodim me te gjithe llogjistikene e nevojshme per delegacione te huaja per te gjitha aktivitetet qe ata do te kryejne ne Republiken e Shqiperise.
5. Blerje, shitje makina te ndryshme.



Neni 5

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrise kapitalin sipas vendime te vete Ortakeve sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni 6

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestari i shoqerise eshte 100.000 (njeqindmije) leke dhe i ndare ne kuota me te njeften vlore por asnjehere me e vogel se 1.000 (njemije) leke. Kapitali perbehet nga 1 kuote dhe zoterothen nga 100% nga ortake i shoqerise **Z.Luan Mata**.

Ortaku mund te vendosi te rrise kapitalin e shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te asamblese se ortakeve sa here qe shoqeria te kete nevoje per tu mbuluar financiarisht per zhvillimin normal te aktivitetit te saj kur ajo te kete te papaguar furnitore, mungesa te likujditetit ose dhe me kontribut ne natyre.

Detyrimet e ortakut kundrejte shoqerise do te mbulohen vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tij. Ortaku nuk do te kete asnje perjegjesi tjeter per detyrimet e tjera te shoqerise.

Shoqeria nuk perjigjet per detyrime te marra nga administratori per qellime qe nuk perputhen me ato te paracaktuara nga ky Statut, si edhe per detyrime te marra nga Ortaku ne emrin e tij personal.

Neni 7

REGJISTRIMI I SHOQERISE

Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare t e Biznesit (QKB) sipas nenit 43 te ligjit 9723 date 3.5.2007.

Neni 8

KALIMI I KUOTAVE DHE E DREJTA E PARABLERJES

Kuotat e kapitalit te shoqerise si dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen nepermjet:



- a) kontributit ne cash dhe ne natyre ne kapitalin e shoqerise
- b) shitblerjes se kuotave
- c) trashegimise
- d) dhurimit
- e) çdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe fiton ate per gjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes nga çasti i kalimit te kuotave deri ne çastin e regjistrimit te kalimit.

- Pjeset e kapitalit mund t'u transferohen te treteve teresisht ose pjeserisht, vetem me vendimet e Asamblese se Ortakeve.
- Transferimi per cfaredo arsyje, teresisht ose pjeserisht i pjeseve te kapitalit te Shoqerise eshte subjekt i se drejtë se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere, te cilet mund te ushtrojne kete te drejte ne raport me pjeset e tyre te kapitalit, brenda 30 (tridhjete) ditesh nga marrja e njoftimit te derguar me leter rekomandimi. Ne kete njoftim duhet te saktesohet çmimi i kerkuar, i cili duhet te jete i arsyeshem dhe i njejtë me ate qe do t'i ofrohet nje personi te trete , jashte shoqerise. Ne rast se ortaket e tjere nuk per gjigjen brenda afatit te parashikuar, konsiderohet se ata kane hequr dore nga ushtrimi i se drejtës se parablerjes.
- Te gjitha njoftimet e siper permendura do te behen me shkrim dhe i adresohen Administratorit te Shoqerise.

Neni 9

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emri i administratorit, duhet te jete te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

Neni 10

Shoqeria vepron nen regjin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore.

Organet e shoqerise jane:

- 1- Asambleja e Ortakeve te Shoqerise
- 2- Administratori



Neni 11

KOMPETENCAT E ORTAKEVE TE SHOQERISE

Per menyren e drejimit dhe ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, Asambleja Ortakeve shprehet me vendime per gjithcka qe eshte ne kompetencat e saj te peshkruara si me poshte:

- Ka te drejte te beje ndryshime ne statut.
- Percakton politikat tregtare te shoqerise.
- Ka te drejte te miratoje bilancin e shoqeris edhe te beje ndarjen e fitimit.
- Ai emeron ose shkarkon administratoret, likuiduesit, ekspertet kontabel te autorizuar.
- Mbikqyr zbatimin e politikave tregetare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Miratimin e pasqyrave vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Miraton zmadhimin ose zvogelin e kapitalit.
- Percakton shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.
- Miraton pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- I jep autorizimin Administratorit ta perfaqesoj shoqerine ne gjykate, kryen riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miraton rregullat procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- Miraton lidhjen e kontratave per dhenie dhe marrje te drejtrash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise si dhektronatanelidhje me organetshteterore per pjesmarrjenne tender, ankande ose aktivitete te tjera te rendesishme.
- Realizonblerje, shitje si dhetjetersim te pasurive te palujtshme te shoqerisene perputhje me kriteretqe i jepligji per shoqeritet regetaret.
- Merrvendime te tjeranedobi te veprimtariset regetare.

Neni 12

Marrja e vendimeve te Ortakeve regjistrohet ne regjistrin e vendimeve te ortakeve, mbajtja e procesverbalevedhe te gjitha dokumentat e tjera qekane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per keteqellim.

Neni 13



THIRRJA E ASAMBLESE

Asambleja e per gjithshme thirret sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se per gjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

Asambleja e per gjithshme thirret nga Administratoret ose nga ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme te Shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Njoftimi ne te dyja format e mesiperme duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites.

Neni 14

PJESEMARRJA NE VENDIME

Çdo ortak, ne rastet kur shoqeria do te kete me shume se nje ortak, ka te drejte te marre pjese ne vendime si dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote,qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja duhet te vendose per ceshtje qe kerkojne shumice te kualifikuar si per shembull ndryshime ne statut,zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te regjistruar, shperndarja e fitimeve,riorganizimi dhe shperndarja e shoqerise,ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 50% te kuotave, dhe votojne pro tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres personalisht, ose qe votojne me shkrese apo me mjete elektronike.

Neni 15

ADMINISTRIMI

Shoqeria administrohet nga njeadministrator i cili caktohetne statutin e shoqerise nga Asambleja e Ortakeve. Administratori qendron ne detyre per nje periudhe jo me te gjate se 5 vjet me te drejte riparteritje kohore dhe ne rast se

gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e tij, asambleja e ortakeve vendos shkarkimin e tij per shkaqe te arsyeshme.

Administratori detyrohet te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise duke zbatuar politikat tregetare te vendosura nga asambleja e pergjithshme.

Ai kujdeset per mbajtjen sakte dhe te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise.

Ai pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor te shoqerise, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumente para asamblese se pergjithshme per miratim.

Ai ka te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise jua jep shprehimisht Asamblese se ortakeve.

Administratori ka te drejte te nenshkruajne per kontrata te ndryshme, per furnizime publike private, cdo lloj operacioni bankar, te veproje me cdo lloj instituti bankar publik e privat, te ndermarre veprime gjyqesore, transaksione te ndryshme, etj.

Te gjitha veprimet e tjera duke perfshire pagesa dhe detyrime per tu paguar ose veprime me insitucionet bankare ku perfshihen transferta bankare dhe terheqje parash qe do te ndermerren nga Administratori per llogari te shoqerise, eshte e nevojshme dhe e detyrueshme nenshkrimi i Administratorit se bashku me vulen e shoqerise, ne menyre qe keto veprime te jene te detyrueshme per shoqerine.

Administratori nuk mund te kryeje pa miratimin e Asamblese se Pergjithshme:

- Lenien peng ose ne hipoteke te pasurive te shoqerise;
- Shit-blerje te pasurive te paluajteshme ne pronesi te Shoqerise;
- Te kontrakoje ne cfaredo lloj forme qofte, te marri hua tek shoqeria, te japi pelqimin ne emer te saj per paradhenie si dhe te behet dorezanes apo te garantoje ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve

Administratori i shoqerise eshte **z. Safet Mija** shtetas shqiptare, me numer personal **I60401071T**, madhor me zotesi te plete juridike per te vepruar. Ai do ta ushtroje kete detyre per nje periudhe 5 vjecare. Me te drejte rinovimi.



Neni 16

MARREDHENIET E PUNES

Marredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimitdhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojn Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 17

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i shoqerise.

Neni 18

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet nga asambleja e ortakeve. Ortaku cakton dhe shperblimin perkates midis tyre si marredhenie dy paleshe.



Neni 19

VITI FINANCIAR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Viti finanziar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit. Administratori merr masat lidhur me perllogaritjen e rezultateve ekonomike te fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit te ceshtjeve te mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, mbasi ekspertri kontabel ti kete certifikuar ato si te verteta dhe te sinqerta atehere asambleja vendos se cfare do te bej me fitimin apo humbjen e shoqerise ne se do te ndahen si divident apo do te shtoj kapitalin e saj.

Neni 20

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Ne rast se shoqeria shperndahet per cdo lloj arsyet Ortaket vetem percaktojne menyren e likuidimit, emeron nje ose me teper likuidator dhe perbatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c'regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

NENI 21

ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij Statuti do te zgjidhen me mirekuptim dhe do te diskutohen ne menyre te drejtperdrejte midis paleve te interesuara.

Ne rast se nuk do te arrihet nje zgjidhje me mirekuptim te mosmarreveshjes, ajo do t'i besohet Gjykates se Rrethit Tiranë.

Neni 22

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare" dhe ligjit nr.9723. date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit". Cdo ndryshim behet ne perputhje me kete Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie per cdo gje qe nuk eshte shprehur ne statut merret ne konsiderate ligji dhe aktet nenligjore ne fuqi



Statuti eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

Tirane, me: 23/11/2023

ORTAK I SHOQERISE

Luan Mata

Luan Mata

Luan Mata